

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË
STUDIMET E DOKTORATËS



FESTIME MEHDIU, PhDc.

**ANGLICIZMAT NË ARSIMIN E LARTË NË
KOSOVË PAS VITIT 1999**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”

FACULTY OF PHILOLOGY

DOCTORAL STUDIES



FESTIME MEHDIU, PhDc.

**ANGLICISMS IN HIGHER EDUCATION IN
KOSOVO AFTER 1999**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2024

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË
STUDIMET E DOKTORATËS



FESTIME MEHDIU, Ph.Dc.

**ANGLICIZMAT NË ARSIMIN E LARTË NË
KOSOVË PAS VITIT 1999**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof.Dr. Milote Sadiku

Prishtinë, 2023

Përmbledhje

Të paktën që nga shekulli i 19-të filologët studiuhan sistematikisht huazimet dhe procesin e të huazuarit, kryesisht në kontekstin e gjuhësisë historike dhe bënë përpjekje për të identifikuar familjet gjuhësore dhe për të vendosur trungun gjenealogjik me anë të rindërtimit të gjuhëve paraardhëse. Në këtë kontekst lindi teoria se disa pjesë të leksikut dhe gramatikës duket të jenë më rezistente, apo immune, ndaj huazimit se disa të tjera dhe në këtë mënyrë më të dobishme për rindërtimet gjenealogjike. Kjo ide është diskutuar nga shumë autorë si Whitney (1881), Paul (1920), Meillet (1921), Haugen (1950), Weinreich (1953) dhe - me një përqëndrim të veçantë te foljet - nga Moravcsik (1975, 1978, 2003) (krh. Wohlgemuth, 2009: 7).

Të huazuarit kryhet nëpërmjet individëve, madje nëpërmjet individëve të posaçëm të një komuniteti. Individët, sidomos të arsimuarit që ushtrojnë profesione të ndryshme, huazojnë elemente të ndryshme nga gjuhët e huaja, secili në fushën e profesionit. Për këtë arsye nuk mund të dihet asnjëherë me saktësi se cilat fjalë të huaja janë huazuar deri në një kohë të caktuar. Në shumë fusha huazimet mbasin për një kohë të gjatë inventar gjuhësor “intern” d.m.th. vetëm i atij grupi që ushtron atë lëmi: vetëm pjesëtarët e atij grupi të ngushtë profesional komunikojnë mes vete duke përdorur huazimet e caktuara.

Mendohet se huazimet në përgjithësi plotësojnë vendet e zbrazëta në gjuhën marrëse. Kur një popull prodhon diçka të vlefshme edhe për popujt e tjerë, të tjerët e marrin jo vetëm atë material ose gjësend, por nëse në gjuhën e tyre nuk kanë emërtim për të – e marrin edhe emrin e atij gjësendi ose materiali. Gjërat e reja zakonisht vijnë me emra të rinj. Pra, nevoja për t’i emërtuar gjërat dhe konceptet e reja sipas Weinreich cituar sipas Nuhiut (1990:11) është një ndër shkaqet e përgjithshme për rrisitë leksikore.

Disa folës huazojnë fjalë të huaja për të treguar nivelin e lartë intelektual, gjoja se njohin një gjuhë të huaj e me të madhe një kulturë të huaj. Kjo ndodhë, veçanërisht, kur ajo gjuhë e huaj ka prestigj të lartë në atë vend ose në botë. Anglishtja dal-ngadalë merr rolin e gjuhës ndërkombëtare, të ashtuquajturës gjuhë botërore a globale, rol ky që disa shekuj para saj e ka pasur frëngjishtja, e para

frëngjishtes latinishtja. Rëndësia e gjuhës angleze për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të një vendi është e padiskutueshme.

Gjuha shqipe gjatë kontakteve me gjuhë të tjera ka marrë fjalë, shprehje që i janë nevojitur për komunikim midis folësve të saj në rrethana të ndryshme. Me kohë fjalët e huazuara janë bërë pjesë e bërthamës shqipe, u janë nënshtruar ligjeve të zhvillimit të saj dhe i kanë humbur shenjat dalluese e të qenit fjalë e huaj.

Nuk ka kriter të mirëfilltë të pranimit të drejtpërdrejtë të disa huazimeve dhe të përjashtimit të tjerave. Gjuha shqipe ka përvetësuar një korpus të caktuar fjalësh nga anglishtja, duke e përshtatur, sa është e mundur, nga aspekti fonetik e semantik.

Në përmasat që kanë sot, anglicizmat në gjuhën shqipe janë fenomen i ri. Ky fenomen i gjithpranishëm tash u detyrohet rrethanave: kontakte të pandërmjetme dhe kryesisht pësuese të diaspora tashmë një shekull në Amerikë. Sot pak a shumë e tërë bota shqiptare ka kontakte intensive me gjuhën (apo gjuhët) angleze në të gjitha rrafshet. Siç pohon Sejdiu – Rugova (2013: 281), gjuha angleze është përshkruar nga David Crystal si një gjuhë që huazon e pangopur dhe sipas tij më shumë se 120 gjuhë botërore kanë shërbyer si burim i fjalësit të sotëm të anglishtes. Megjithatë, anglishtja sot paraqet një dhënës kryesor gjuhësor, është burim themelor i huazimeve në shumë gjuhë të botës. As shqipja nuk bën përjashtim në këtë rrafsh. Fjalët nga anglishtja vazhdimisht adaptohen për t'u përdorur në gjuhën shqipe.

Preokupimi me anglicizmat gjithmonë përfshin konsideratën e gjuhës angleze në kontekst global, i cili, të paktën në mënyrë indirekte, ndikon në huazimin e fjalëve ose elementeve gjuhësore angleze në gjuhët e tjera (Fischer & Pulaczewska, 2008: 2).

Përdorimi i anglishtes në Kosovë në dy dekadat e fundit ka qenë shumë i dendur. Pikërisht ky ndikim i gjuhës angleze në gjuhën shqipe është objekt i kësaj teze të doktoratës.

Në këtë punim së pari do të shtjellohen bazat teorike dhe terminologjike të studimit të kontaktit gjuhësor, me fokus të veçantë në procesin e huazimit nga anglishtja në shqip. Pastaj do të analizohen dokumente të ndryshme të arsimit të lartë në Kosovë për të parë sa është numri i anglicizmave të përdorur në shqip, cilët anglicizma përdoren më së shpeshti, si dhe përmes krahasimit të ligjeve të arsimit të lartë të periudhës para vitit 1999 dhe pas vitit 2000, do të shohim nëse ka rritje të vazhdueshme gjegjësisht sa është rritur numri i anglizmave në shqip.

Ndërsa për të hulumtuar nëse këta anglicizma që përdoren në dokumentet e fushës së arsimit të lartë kuptohen dhe përdoren edhe nga studentët e mësimdhënësit, është zhvilluar edhe një pyetësor, me anë të të cilit do të anketohen disa studentë e mësimdhënës të UP-së.

Në këtë tezë të doktoratës do të bëhet përpjekje të paraqitet sa më mirë çështja e përdorimit të anglicizmave, të cilët i ka huazuar gjuha shqipe në fushën e arsimit të lartë në Kosovë. Për qëllime të këtij studimi është hulumtuar përdorimi i anglicizmave në dokumente të arsimit të lartë si në vijim:

- hulumtimin e anglicizmave të përdorur në vendimet e nxjerra nga Rektorët e Universitetit të Prishtinës që nga viti 2000 deri në vitin 2020 – vit ky i fundit për hulumtimin tonë;
- hulumtimin e anglicizmave të përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës
- hulumtimin e anglicizmave në *Monografinë 50 vjet Universitet 1970 – 2020* si një dokument i cili është përpiluar nga Universiteti i Prishtinës
- hulumtimin e anglicizmave në Monografinë 35 vjet të Fakultetit të Filologjisë (1960 – 1995)
- hulumtimin e anglicizmave të përdorur në Ligjin/et për Arsimin e Lartë në Kosovë para vitit 1999
- hulumtimin e anglicizmave të përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë
- hulumtimin e anglicizmave në dokumente tjera relevante në fushën e arsimit të lartë në Kosovë.

Fjalët kyçe: anglicizmat, huazim, arsim i lartë, Kosovë, gjuha shqipe, gjuha angleze, ligji

Resume

Since at least the 19th century, philologists have systematically studied borrowing and the process of borrowing, mainly in the context of historical linguistics, and have attempted to identify language families and establish genealogical lineages through the reconstruction of ancestral languages. In this context, the theory arose that some parts of the lexicon and grammar seem to be more resistant, or immune, to borrowing than others and thus more useful for genealogical reconstructions. This idea has been discussed by many authors such as Whitney (1881), Paul (1920), Meillet (1921), Haugen (1950), Weinreich (1953) and - with a special focus on verbs - by Moravcsik (1975, 1978, 2003)) (cf. Wohlgemuth, 2009: 7).

Borrowing is done through individuals, even through special individuals of a community. Individuals, especially educated people who practice different professions, borrow different elements from foreign languages, each in the field of profession. For this reason, it can never be known precisely which foreign words were borrowed until a certain time. In many fields, borrowings remain for a long time "internal" linguistic inventory, i.e. only of that group practicing that profession: only members of that narrow professional group communicate with each other using certain borrowings.

Borrowings are generally thought to fill gaps in the receiving language. When people produce something valuable for other people, others take not only that material or thing, but if they don't have a name for it in their language - they also take the name of that thing or material. New things usually come with new names. So, the need to name new things and concepts according to Weinreich quoted according to Nuhiu (1990:11) is one of the general causes for lexical innovations.

Some speakers borrow foreign words to show a high intellectual level, supposedly knowing a foreign language and even more, a foreign culture. This happens, especially, when that foreign language has high prestige in that country or in the world. English is slowly taking on the role of the international language, the so-called world or global language, a role that French had a few centuries ago. The importance of the English language for the overall economic, social and cultural development of a country is indisputable.

Albanian, during contacts with other languages, has acquired words, expressions that are necessary for communication between its speakers in these different things. Over time, the borrowed words have become part of the Albanian core, they have been subjected to its other laws and have lost the distinctive signs of being foreign words.

There is no real criteria for directly accepting some borrowings and excluding others. The Albanian language has acquired a certain corpus of words from English, adapting it, as much as possible, from the phonetic and semantic aspects.

In the proportions they have today, anglicisms in the Albanian language are a new phenomenon. This omnipresent phenomenon is now due to the circumstances: direct and mostly passive contacts with the diaspora for a century in America. Today, more or less the entire Albanian world has intensive contacts with the English language (or languages) on all levels. As Sejdiu - Rugova (2013: 281) asserts, the English language has been described by David Crystal as a language that borrows insatiably, and according to him, more than 120 world languages have served as the source of today's English vocabulary. However, English today represents a major linguistic donor, it is the basic source of borrowings in many languages of the world. Nor is Albanian an exception in this regard. Words from English are constantly being adapted to be used in the Albanian language.

The preoccupation with anglicisms always involves the consideration of the English language in a global context, which, at least indirectly, affects the borrowing of English words or linguistic elements into other languages (Fischer & Pulaczewska, 2008: 2).

The use of English in Kosovo in the last two decades has been very dense. It is this influence of the English on the Albanian language that is the subject of this doctoral thesis.

In this paper, first, the theoretical and terminological bases of the study of language contact will be elaborated, with a special focus on the borrowing process from English to Albanian. Then various documents of higher education in Kosovo will be analysed to see how many anglicisms are used in Albanian, which anglicisms are used most often, as well as, through a comparison of the higher education laws of the period before 1999 and after year 2000, we will see if there is a continuous increase, namely how much the number of anglicisms in Albanian has increased.

In order to research whether these anglicisms used in documents in the field of higher education are understood and used by students and teachers, a questionnaire has also been developed, through which some students and teachers of UP will be surveyed.

In this doctoral thesis, an attempt will be made to present the issue of the use of anglicisms, which the Albanian language has borrowed in the field of higher education in Kosovo. For the purposes of this study, the use of anglicisms in higher education documents has been researched as follows:

- the research of anglicisms used in the decisions issued by the Rectors of the University of Pristina from 2000 to 2020 - the last year for our research;
- the research of anglicisms used in the Law on Higher Education in the Republic of Kosovo
- the research of anglicisms in the *Monograph 50 years of the University 1970 – 2020* as a document compiled by the University of Pristina
- the research of anglicisms in the *Monograph 35 years of the Faculty of Philology (1960 - 1995)*
- the research of anglicisms used in the Law/s on Higher Education in Kosovo before 1999
- the research of anglicisms used in the Law on Higher Education in the Republic of Albania
- the research of anglicisms in other relevant documents in the field of higher education in Kosovo.

Keywords: Anglicisms, borrowing, higher education, Kosovo, Albanian language, English language, law